REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MBIKËQYRJES SË TREGUT

Nr.1264/1 Prot. Tiranë, më 05.03.2026

UDHËZIM

Nr. 1 datë 05.03

PËR
"PROCEDUREN E REGJISTRIMIT, ÇREGJISTRIMIT, NDRYSHIMIT DHE PËRDITËSIMIT TE TË DHËNAVE , SI DHE ADMINISTRIMIT TË REGJISTRAVE TË ASHENSORËVE PRANË ISHMT".

Në mbështetje të Ligjit Nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligjit Nr. 10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore",të ndryshuar; VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim", të ndryshuar; VKM Nr. 192, datë 04.04.2018, "Për miratimin e rregullit teknik 'Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"; VKM Nr. 36 , datë 20.01.2016 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut", të ndryshuar, pika 8 gërmat c) dhe ç), si dhe pika 9:

Me qëllim unifikimin e praktikës administrative, rritjen e qartësisë procedurale dhe përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e zbatimit të procedurave të regjistrimit të ashensorëve, çregjistrimit të tyre, si dhe ndryshimit dhe përditësimit të të dhënave në Regjistrat e Ashensorëve dhe në certifikatat përkatëse, në funksion të garantimit të një administrimi të saktë, të njëtrajtshëm nga struktura përgjegjëse e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut,

UDHËZOJ:

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i qartë dhe rregullimi i detajuar i procedurave që ndiqen për regjistrimin për herë të parë të ashensorit pranë ISHMT-së, pajisjen e personit përgjegjës me certifikatën e regjistrimit për herë të parë , si dhe çregjistrimin,

ndryshimin dhe përditësimin e regjistrit të ashensorëve. Kjo procedurë synon përmirësimin e protokolleve të deritanishme të zbatuara nga ISHMT.

2. Kjo procedurë zbatohet kur ashensori regjistrohet për herë të parë dhe hartohet certifikata, kur bëhet çregjistrimi i ashensorit, kur bëhen ndryshime dhe përditësime në të dhënat në regjistër dhe në certifikatat që preken nga ky proces.
3. Procedura e ndryshimit zbatohet në rastet kur konstatohet një akt që përmban gabime të karakterit teknik, përshkrues ose shkrimor, si: emër i gabuar, numër protokolli i gabuar, datë e pasaktë, numër serial i pasaktë, etj.
4. Procedura e përditësimit zbatohet në rastet kur gjendemi; përpara ndryshimit të adresave nga institucionet kompetente; përpara ndryshimit të personit përgjegjës të ashensorit, për shkak të ndryshimit të pronësisë së objektit në të cilin është instaluar ashensori/ët; përpara ndryshimit të numrit serial të ashensorit, si pasojë e ndërhyrjeve të kryera pas kontrollit nga organet e miratuara, apo në rastet e modernizimit të ashensorit, sipas pikës 6 të VKM nr. 1056, datë 23.12.2015, "Për miratimin e rregullit teknik 'Për sigurinë e ashensorëve në përdorim'", i ndryshuar.
5. Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve dhe Sektori i Produkteve Mekanike janë përgjegjës për zbatimin e kësaj procedure.

6. Procedura për regjistrimin e ashensorit

a) **Ashensorët ekzistues**

Referuar parashikimeve të VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim", të ndryshuar, *"Ashensor ekzistues"* është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim përpara datës 31 dhjetor 2019.

Referuar parashikimeve të ligjit Nr.10489, datë 15/12/2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, dhe të VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim" të ndryshuar, dokumentat që duhet të dorëzohen nga subjektet për regjistrimin e ashensorit për herë të parë pranë ISHMT-së duhet të përfshijnë:

i. **Formularin e regjistrimit të plotësuar;**
ii. **Kopje të Raportit të Ekzaminimit të parë të plotë të ashensorit ekzistues.**

b) **Ashensorët e rinj**

Në bazë të VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim", të ndryshuar", *"Ashensor i ri"* është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim, duke filluar që prej datës 1 janar 2020.

Referuar parashikimeve të VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim", dokumentat që duhet të dorëzohen nga subjektet për regjistrimin e ashensorit për herë të parë pranë ISHMT-së duhet të përfshijnë:

i. **Formularin e regjistrimit të plotësuar;**
ii. **Kopje të deklaratës së konformitetit të ashensorit dhe të komponentëve të tij të sigurisë.**

Kopjet e Raportit të Ekzaminimit të parë të plotë të ashensorit ekzistues lëshohen nga Organet e Miratuara nga Ministria e linjës dhe duhet të jenë të vlefshme dhe kaluese.

c) **Rastet kur kryhet regjistrimi i ashensorit**

Regjistrimi i ashensorit për herë të parë në ISHMT kryhet:

i. Kur instalohet ashensor i ri në objekt;
ii. Kur kryhet ekzaminimi i parë i plotë në një ashensor ekzistues.

d) **Subjekti përgjegjës për kërkesën e regjistrimit**

Subjekti i detyruar për paraqitjen e kërkesës për regjistrimin e ashensorit pranë ISHMT-së është personi përgjegjës sipas parashikimeve të legjislacionit për mbikëqyrjen e tregut.

e) **Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim**

Dokumentet që duhet të paraqiten pranë ISHMT-së për regjistrimin e ashensorit janë:

i. Kërkesë (format i unifikuar) për regjistrimin e ashensorit.
Kërkesën e regjistrimit, çdo person përgjegjës mund ta shkarkojë nga ëeb- site i ISHMT- së: www.ishmt.gov.al ose mund ta gjejë pranë zyrave të ISHMT-së.
Kërkesa është e miratuar sipas Aneksit 1.
ii. Formulari i regjistrimit, ku çdo person përgjegjës mund ta shkarkojë nga ëeb-site i ISHMT-së: www.ishmt.gov.al ose mund ta gjejë pranë zyrave të ISHMT-së. Formati i regjistrimit është miratuar dhe përpiluar në përputhje me parashikimet e VKM-së Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim", të ndryshuar, miratuar me Urdhër të Kryeinspektorit. Formulari i regjistrimit është i miratuar sipas Aneksit 1.
iii. Kopje të Raportit të Ekzaminimit të Parë të Plotë për ashensorët ekzistues, lëshuar nga një Organ i Miratuar i vlefshëm dhe kalues.
iv. Vleresimi i konformitetit, kopje të deklaratës së konformitetit të ashensorit dhe të komponentëve të tij të sigurisë për ashensorët e rinj.
v. Deklaratë EU e instaluesit të ashensorit për ashensorët e rinj.
vi. Listë e komponentëve të sigurisë së ashensorit lëshuar nga instaluesi për ashensorët e rinj.

f) **Procedura e regjistrimit**

Procedura e verifikimit dhe trajtimit të kërkesës për regjistrimin e ashensorit zhvillohet si më poshtë:

i. Dokumentacioni i plotë për regjistrim depozitohet pranë ISHMT-së, në përputhje me format ligjore të përcaktuara;
ii. Dokumentacioni shoqërohet me kartelë shoqëruese dhe përcillet në Sektorin e Produkteve Mekanike;
iii. Dokumentacioni verifikohet nga grupi i inspektorëve të Sektorit të Produkteve Mekanike, të cilët hartojnë një memo sipas Aneksit 1. Pas pranimit nga Përgjegjësi i Sektorit të

Produkteve Mekanike, memoja i përcillet Drejtorit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve;

iv. Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve shqyrton dhe miraton kërkesën dhe ia përcjell Kryeinspektorit për konfirmimin ose jo të pajisjes së kërkuesit me Certifikatën e Regjistrimit të Ashensorit.

Pas konfirmimit nga Kryeinspektori, të dhënat përkatëse regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Ashensorëve, të krijuar pranë ISHMT, nga personi i autorizuar. Këto të dhëna shërbejnë për plotësimin e Certifikatës së Regjistrimit të Ashensorit. Më tej, përgatitet kopja fizike e certifikatës, kryhet protokollimi i procedurës, skanimi dhe krijimi i lidhjes elektronike ("hyperlink") në regjistër.

Një kopje e shkresës përcjellëse, së bashku me Certifikatën e Regjistrimit të Ashensorit, depozitohet në zyrën e protokollit të institucionit, një kopje ruhet në Sektorin e Produkteve Mekanike, ndërsa një kopje i vihet në dispozicion subjektit të interesuar, e cila tërhiqet pranë zyrës së protokollit të institucionit, pas njoftimit.

Procedura e vlerësimit të dokumentacionit, regjistrimit, hedhjes në regjistër dhe lëshimit të Certifikatës së Regjistrimit të Ashensorit përfundon brenda një afati jo më të gjatë se 10 (dhjetë) ditë pune pas protokollimit të kërkesës së plotë.

7. Regjistri i ashensorëve, struktura dhe administrimi i tij

a) Pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut mbahet "**Regjistri i Ashensorëve**", i cili administrohet në format elektronik dhe fizik, për qëllime administrimi, gjurmueshmërie dhe unifikimi të certifikatave të regjistrimit të ashensorëve.

b) Regjistri elektronik i ashensorëve mbahet në formatin "excel", sipas Aneksit 1, dhe përbëhet nga tre "sheet" të emërtuara si më poshtë:
   i. "REGJISTRI_ASHENSOREVE";
   ii. "PERIODIKET";
   iii. "NDRYSHIM_PERDITESIM".

c) Në "sheet"-in "REGJISTRI_ASHENSOREVE" pasqyrohen të dhënat bazë të ashensorit, të cilat shërbejnë për përgatitjen e certifikatës së regjistrimit.
   Në "sheet"-in "PERIODIKET" pasqyrohen të dhënat e ekzaminimeve të plota dhe/ose periodike të kryera nga Organet e Miratuara.
   Në "sheet"-in "NDRYSHIM_PERDITESIM" pasqyrohen të dhënat që lidhen me procedurat e ndryshimit dhe përditësimit të regjistrimit.

d) Regjistri i ashensorëve ndahet në dy periudha në regjistra:
   i. **Certifikatat aktuale (CA)** ku përfshihen të gjithë ashensorët e regjistruar deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.
   ii. **Certifikatat e reja (CR)**, ku përfshihen të gjithë ashensorët që do të regjistrohen pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

e) Regjistri ekzistues shërben për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave historike dhe nuk shfuqizohet, por vijon të mbahet për qëllime reference, kontrolli dhe gjurmueshmërie.
f) Certifikatat e regjistrimit të përfshira në regjistrin ekzistues identifikohen me nr serial të certifikatës me:
   i. shkurtimin "CA" (Certifikatë Aktuale);
   ii. një numër rendor katër (4) shifror, sipas rendit kronologjik të lëshimit.
g) Regjistri i ri i ashensorëve përbën regjistrin zyrtar aktiv dhe përfshin të gjitha certifikatat e regjistrimit të lëshuara pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.
h) Certifikatat e regjistrimit në këtë regjistër identifikohen me nr serial të certifikatës "CR" (Certifikatë e Re), të përbëra nga:
   i. Shkurtimin CR (Certifikatë e Re);
i) ii. një numër rendor pesë (5) shifror, unik dhe progresiv;
j) Regjistrat që mbahen në format elektronik dhe përmbajnë lidhje elektronike ("hyperlink") me dokumentacionin përkatës të çdo procedure regjistrimi, ndryshimi, përditësimi apo çregjistrimi.
k) Për administrimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave caktohet një person përgjegjës për regjistrin, i cili:
   i. sugjerohet nga Përgjegjësi i Sektorit të Produkteve Mekanike;
   ii. miratohet me urdhër të Kryeinspektorit për një afat tre (3) mujor, me mundësi rinovimi.
l) Personi përgjegjës për regjistrin mban përgjegjësi për:
   i. saktësinë e të dhënave të regjistruara;
   ii. respektimin e ndarjes midis regjistrit ekzistues dhe regjistrit të ri;
   iii. ruajtjen e gjurmueshmërisë së çdo veprimi të kryer mbi të dhënat e regjistrit.
m) Çdo ndërhyrje, korrigjim apo shtesë në regjistra kryhet vetëm në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë udhëzim dhe dokumentohet në mënyrë të plotë.

8. Certifikata e Regjistrimit

a) Për çdo ashensor të regjistruar lëshohet një certifikatë regjistrimi, e cila përputhet me të dhënat e regjistrit të ashensorëve dhe formatet e përcaktuara në Aneksin 1.
   Certifikata përmban të dhënat identifikuese të ISHMT- së, si dhe të ashensorit dhe të personit përgjegjës, të përbëra nga:

i. Logo dhe adresa e ISHMT-së;
ii. Shkrimi "CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË ASHENSORIT";
iii. Numri unik i regjistrimit të ashensorit, i cili përmban:

- iii. shkurtimin përkatës të distriktit sipas Aneksit 1;

- Baza ligjore e regjistrimit;
- Data efektive e regjistrimit;
- Numri serial i ashensorit;

- Modeli i ashensorit dhe emri i instaluesit/mirëmbajtësit;
- Qëllimi i përdorimit;
- Vendndodhja e ashensorit (adresë e detajuar);
- Personi përgjegjës;
- NIPT / ID i personit përgjegjës;
- Numri i identifikimit të Organit të Miratuar (OM);
- Vlerësimi i konformitetit.
- Shënimi CR me një numër rendor pesë (5) shifror, unik dhe progresiv;
- Adresa e Institucionit;

b) Njoftimi për detyrimin ligjor të personit përgjegjës për çdo ndryshim të dhënash të certifikatës: *"Personi përgjegjës duhet të njoftojë ISHMT-në për çdo ndryshim që prek të dhënat e kësaj certifikate";*

c) Firma e Kryeinspektorit dhe vula e ISHMT-së.

d) Lëshimi i certifikatës bëhet vetëm për ashensorët që i janë nënshtruar ekzaminimit të plotë fillestar nga një Organ i Miratuar.

e) Të dhënat e certifikatës duhet të përputhen plotësisht me të dhënat e regjistrave përkatës elektronik dhe fizik (REGJISTRI_ASHENSOREVE dhe sheet-et e tjera përkatëse) dhe çdo ndryshim apo përditësim i të dhënave të regjistrit pasqyrohet menjëherë në certifikatë.

9. Çregjistrimi i ashensorëve

a) **Rastet kur kryhet çregjistrimi**

Çregjistrimi i ashensorit kryhet në rastet e mëposhtme:

i. Ashensori është çinstaluar përfundimisht nga objekti;
ii. Ashensori çinstalohet me qëllim instalimin e një ashensori të ri në të njëjtin objekt.
iii. Subjekti përgjegjës kërkon cregjistrimin, për shkak të ndryshimeve strukturore në objekt që e bëjnë të pamundur përdorimin e ashensorit.

b) **Subjekti kërkues për çregjistrimin**

i. Kërkesa për çregjistrim dorëzohet nga personi përgjegjës i ashensorit me iniciativën e tij ose si rrjedhojë e detyrimit nga procedura e inspektimit;

c) **Dokumentacioni i nevojshëm për çregjistrimin**

Subjekti duhet të dorëzojë pranë ISHMT-së:

i. Kërkesë me shkrim për çregjistrim, ku argumentohet arsyeja dhe paraqitet situata faktike;
ii. Foto ose dokumentacion që provojnë gjendjen faktike;
iii. Certifikatë origjinale të regjistrimit, ose kopje të njësuar me origjinalin;
iv. Dokumente shtesë sipas kërkesës së ISHMT, kur është e nevojshme.

d) **Procedura e çregjistrimit**

i. Dokumentacioni për çregjistrim protokollohet pranë ISHMT dhe përcillet në Sektorin e Produkteve Mekanike për trajtim.

ii. Grupi i ngarkuar për shqyrtimin e kërkesës analizon dokumentacionin përkatës.

iii. Në rast nevoje, ISHMT mund të kryejë verifikim fizik në terren dhe/ose të kërkojë informacion shtesë nga subjekti.

iv. Nëse dokumentacioni është i plotë dhe kërkesa vlerësohet e justifikuar, hartohet një Memo, e cila:

- Pranohet nga Përgjegjësi i Sektorit të Produkteve Mekanike;
- Miratohet nga Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve;
- Konfirmohet nga Kryeinspektori.

v. Kryeinspektori merr vendim për çregjistrimin e ashensorit sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 1. Pas marrjes së vendimit:

- Kryhen veprimet përkatëse në regjistrin përkatës të ashensorëve (ekzistues ose i ri), duke shënuar në kolonën përkatëse: "ÇREGJISTRUAR – Vendim Nr. ___, datë ___" dhe ngjyroset me të kuqe rreshti përkatës;
- Protokollohet procedura dhe dokumentacioni i skanuar lidhet me lidhje elektronike ("hyperlink") në regjistrin elektronik.
- Subjekti njoftohet për vendimin përmes shkresës përcjellëse sipas Aneksit 1.

vi. Procedura e çregjistrimit përfundon brenda një afati jo më të gjatë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e protokollimit të kërkesës së plotë.

vii. Për çfarëdo arsye ligjore apo teknike, certifikata e regjistrimit përkatëse, pavarësisht nëse është "CA" apo "CR", shfuqizohet dhe shënohet si e çregjistruar në regjistrin përkatës.

viii. Çregjistrimi i ashensorit pasqyrohet në regjistra me shënimin e datës, arsyes së çregjistrimit dhe aktit administrativ përkatës, duke garantuar ruajtjen e të dhënave historike dhe gjurmueshmërinë e plotë të statusit të ashensorit.

ix. Certifikatat e shfuqizuara ose të çregjistruara nuk prodhojnë më efekte juridike aktive, por ruhen në regjistrat përkatës vetëm për qëllime reference, kontrolli dhe gjurmueshmërie.

10. Ndryshimi i të dhënave

Përkufizimi i ndryshimit

a) *"Ndryshim"* është korrigjimi i gabimeve të karakterit teknik, përshkrues ose shkrimor në të dhënat e regjistruara, të tilla si:

i. Emër i gabuar;

ii. Numër protokolli i gabuar;
iii. Datë e pasaktë;
iv. Numër serial i shkruar gabim;
v. Gabime të tjera materiale që nuk pasqyrojnë situatën reale.

b) *"Ndryshimi"* nuk i referohet natyrës juridike të ashensorit, por vetëm korrigjon informacione të gabuara.

11. Elementët që mund të ndryshohen

a) Ndryshimi mund të aplikohet për elementet e mëposhtëm të certifikatës së regjistrimit:

i. Numri unik i regjistrimit të ashensorit;
ii. Data efektive e regjistrimit;
iii. Numri serial i ashensorit;
iv. Modeli i ashensorit, Instaluesi/Mirëmbajtësi;
v. Qëllimi i përdorimit;
vi. Vendndodhja e ashensorit (adresa);
vii. Personi Përgjegjës;
viii. NIPT/ID i Personit Përgjegjës;
ix. Numri i identifikimit të Organit të Miratuar;
x. Vlerësimi i Konformitetit.

12. Subjekti kërkues për ndryshim

Kërkesa për ndryshim mund të iniciohet nga:
a) Punonjësit e ISHMT gjatë kontrollit administrativ të brendshëm;
b) Subjekti i interesuar në momentin e marrjes së certifikatës ose në çdo kohë tjetër pas konstatimit të gabimit;

13. Dokumentacioni i nevojshëm për ndryshim

Subjekti duhet të dorëzojë në ISHMT:
a) Kërkesë për ndryshim nga personi përgjegjës ose çdo person i autorizuar prej tij;
b) Vetëdeklarim nga personi përgjegjës/mirëmbajtes ose konstatimi nga ana e ISHMT-së.
c) Certifikatë origjinale, ose kopje e njësuar me origjinalin.

14. Procedura e ndryshimit

a) Dokumentacioni protokollohet pranë ISHMT dhe përcillet në Sektorin e Produkteve Mekanike.
b) Grupi i ngarkuar shqyrton dokumentacionin përkatës.

c) Nëse dokumentacioni është i plotë, hartohet një Memo sipas Aneksit 1 e shoqëruar me çertifikatën ekzistuese, për qëllime reference dhe certifikatën e re me shënimin "NDRYSHUAR – Nr. ___, Prot., ___, datë ___", e cila:

i. Pranohet nga Përgjegjësi i Sektorit të Produkteve Mekanike;
ii. Miratohet nga Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve;
iii. Konfirmohet nga Kryeinspektori.

d) Pas konfirmimit:
   i. Kryhen veprimet në regjistrin përkatës të ashensorëve (ekzistues ose i ri), duke shënuar në kolonën përkatëse: me shënimin: "NDRYSHUAR – Nr. ___, Prot., ___, datë ___" dhe ngjyroset me të kuqe rreshti përkatës;
   ii. Në "sheet"-in NDRYSHIM_PERDITËSIM kopjohet plotësisht rreshti përkatës;
   iii. Në "sheet"-in REGJISTRI_ASHENSOREVE plotësohet rreshti i ri, me shënimin "NDRYSHIM" në kolonën përkatëse;
   iv. Protokollohet procedura dhe dokumentacioni i skanuar lidhet me lidhje elektronike ("hyperlink") në regjistër;
   v. Subjekti pas njoftimit tërheq pranë zyrës së protokollit të institucionit certifikatën e re me të dhënat e ndryshuara.

e) Procedura e ndryshimit përfundon brenda një afati jo më të gjatë se 10 (dhjetë) ditë pune, nga data e protokollimit të kërkesës së plotë, duke siguruar që të gjitha të dhënat janë reflektuar në regjistrin elektronik dhe fizik.

15. Përditësimi i të dhënave

a) "Përditësim" është modifikimi i të dhënave të regjistruara për shkak të ndryshimeve faktike, juridike ose teknike që kanë ndodhur pas regjistrimit fillestar.
b) Përditësimi ndryshon përmbajtjen e të dhënave të pasqyruar në situatën e re reale.
c) Përditësimi i të dhënave kryhet në rastet e mëposhtme kur:
i. Ndryshon adresa e ashensorit nga institucionet kompetente për rishikim të adresave;
ii. Ndryshon personi përgjegjës për shkak të ndryshimit të pronësisë së objektit ku është instaluar ashensori;
iii. Ndryshon numri serial i ashensorit si pasojë e kontrollit teknik nga Organet e Miratuara;
iv. Modernizohet/modifikohet ashensori sipas legjislacionit në fuqi;

d) Përditësimi mund të aplikohet për elementët e mëposhtëm:
i. Numri serial i ashensorit;
ii. Personi Përgjegjës;
iii. NIPT/ID i Personit Përgjegjës;
iv. Vendndodhja e ashensorit (adresa e specifikuar);

e) Kërkesa për përditësim të të dhënave kryhet nga personi përgjegjës në rastet e mëposhtme:

i. Kur personi përgjegjës aktual dorëzon kërkesë zyrtare për kalimin e përgjegjësisë tek një subjekt tjetër, e shoqëruar me aktin kontraktual përkatës;

ii. Kur iniciohet nga Organet e Miratuara, përmes njoftimit zyrtar, për ndryshime të konstatuara gjatë kontrolleve;

iii. Kur iniciohet nga Organet shtetërore, përmes njoftimit zyrtar, për ndryshime administrative, si për shembull ndryshimi i adresave.

16. Dokumentacioni për përditësim

Subjektet janë të detyruara të dorëzojnë pranë ISHMT-së dokumentacionin përkatës sipas llojit të ndryshimit:

a) Për ndryshimin e numrit serial:

i. Njoftim zyrtar nga një Organ i Miratuar;

ii. Vlerësim konformiteti që dokumenton ndërhyrjet e kryera.

b) Për ndryshimin e adresës:

i. Njoftim publik nga organet shtetërore ose shkresë specifike;

ii. Dokument që vërteton ndryshimin zyrtar të adresës.

c) Për ndryshimin e personit përgjegjës:

i. Kërkesë nga personi përgjegjës aktual për kalimin e përgjegjësisë tek personi i ri;

ii. Akti i kalimit të përgjegjësisë;

iii. Dokumentacion plotësues sipas kërkesës së ISHMT-së.

17. Procedura e përditësimit

a) Dokumentacioni protokollohet pranë ISHMT-së dhe përcillet në Sektorin e Produkteve Mekanike.

b) Grupi i ngarkuar shqyrton dokumentacionin përkatës.

c) Nëse dokumentacioni është i plotë, hartohet Memo sipas Aneksit 1 e shoqëruar me certifikatën e re me shënimin "Përditësuar – Nr. ___, Prot., ___, datë ___", e cila:

i. Pranohet nga Përgjegjësi i Sektorit të Produkteve Mekanike;

ii. Miratohet nga Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve;

iii. Konfirmohet nga Kryeinspektori.

d) Pas konfirmimit:

i. Kryhen veprimet në regjistrin përkatës të ashensorëve (ekzistues ose i ri), me shënim "PERDITËSUAR _ Nr. ___, Prot., ___, datë ___" dhe ngjyrosja me të kuqe e rrjeshtit;

ii. Në "sheet-in" "NDRYSHIM_ PERDITËSIM" kopjohet rreshti përkatës plotësisht;

iii. Në "sheet-in" "REGJISTRI_ASHENSOREVE" plotësohet rreshti i ri me shënimin "PERDITESUAR" në kolonën e fundit;

iv. Protokollohet procedura dhe dokumentacioni i skanuar lidhet me hyperlink në regjistër;

f) Subjekti pas njoftimit tërheq pranë zyrës së protokollit të institucionit certifikatën e re me të dhënat e ndryshuara.

g) Procedura e përditësimit përfundon brenda një afati jo më të gjatë se 10 (dhjetë) ditë pune, nga data e protokollimit të kërkesës së plotë, duke siguruar që të gjitha të dhënat janë reflektuar në regjistrin elektronik dhe fizik.

18. Ndryshimi dhe përditësimi i certifikatave

a) Në rast se për një ashensor të pajisur me certifikatë regjistrimi ("CA") ose (CR) kryhet një ndryshim, përditësim, modifikim teknik, administrativ ose tjetër, që sipas këtij udhëzimi kërkon përditësim të të dhënave të regjistrimit, certifikata ekzistuese shfuqizohet dhe zëvendësohet me një certifikatë të re regjistrimi ("CR").

b) Certifikata e re e regjistrimit lëshohet sipas rregullave të regjistrit të ri dhe pajiset me numër serial certifikate "CR" me një numër rendor pesë (5) shifror, unik dhe progresiv në përputhje me nenin përkatës të këtij udhëzimi.

c) Shfuqizimi i certifikatës ekzistuese dhe lëshimi i certifikatës së re pasqyrohen në mënyrë të detajuar në regjistrin përkatës, duke garantuar gjurmueshmërinë e plotë midis certifikatës së mëparshme dhe asaj të re.

19. Monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm

a) ISHMT kryen vlerësim periodik të zbatimit të këtij udhëzimi dhe propozon përmirësime sipas nevojës.

b) Çdo ndryshim në legjislacionin bazë duhet të reflektohet menjëherë në këtë udhëzim nëpërmjet amendamenteve përkatëse.

20. Dispozitë kalimtare për regjistrat e ashensorëve

a) Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, regjistri ekzistues i ashensorëve vijon të mbetet në përdorim për qëllime evidencimi, reference, kontrolli dhe gjurmueshmërie, për të gjithë ashensorët e regjistruar dhe certifikuar përpara kësaj date.

b) Regjistri (CR) i ashensorëve krijohet dhe vihet në funksion menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe përdoret ekskluzivisht për regjistrimin dhe certifikimin e ashensorëve dhe certifikatave të reja që lëshohen pas kësaj date.

c) Certifikatat e regjistrimit të ashensorëve të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi ruajnë vlefshmërinë e tyre ligjore, dhe evidentohen në regjistrin elektronik dhe fizik ekzistues me shkurtimin **"CA"** dhe numër rendor katër (4) shifror.

d) Çdo procedurë regjistrimi, ndryshimi, përditësimi apo çregjistrimi që iniciohet pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi trajtohet sipas dispozitave të tij.

e) Certifikatat aktuale (CA) do të konsiderohen të gjithë ashensorët e regjistruar deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Certifikatat e reja (CR) do të konsiderohet cdo certifikatë e lëshuar pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.
f) Regjistri fizik i ashensorëve do të jetë në të njëjtin format me atë elektronik. Ky regjistër do të ndahet me volume, ku secili volum ka 50 fletë të përbëra nga 15 rreshta secila.
g) Regjistri fizik (CR) do të sekretohet në momentin që do të vihet në funksion dhe në cdo flete të tij.
h) Regjistri fizik (CA) do të administrohet sipas formatit Exel në mënyrë të printuar.
i) Në rastet e gabimeve (njerëzore) në regjistër, do të vijëzohet rreshti në të cilin është bërë gabimi dhe do të vijohet në rreshtin pasardhës.

21. Anekset

Pjesë integrale e këtij udhëzimi është Aneksi 1.

22. Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit. Urdhër Nr 101, datë 24.04.2023 "Për miratimin e procedurës së regjistrimit të ashensorëve për herë të parë në ISHMT.", shfuqizohet.

KRYEINSPEKTOR
Edison Konomi